



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E LIPJANIT
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Pranuar me: Priljeno: 28.05.2024		
Njësia Jednic:	Numri Broj:	Shtojca Dodatak:
05-453/01-26243		



REPUBLIKA E KOSOVËS

KOMUNA E LIPJANIT

REPUBLIKA KOSOVA

OPŠTINA LIPLJAN

REPUBLIC OF KOSOVO

MUNICIPALITY OF LIPJAN

Lipjan, 28.05.2024

RISHPALLJE

Thirrje publike për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve të regjistruara.

1. Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport bënë thirrje të gjitha organizatave jo-qeveritare të Regjistruara në Republikën e Kosovës që veprimtarinë e vet e zhvillojnë në Komunën e Lipjanit të aplikojnë për mbështetje financiare për projektet që kontribuojnë në *avancimin dhe afirmimin e kulturës dhe sportit në Komunën e Lipjani*.

2. OJQ-të në përputhje me këtë thirrje publike mund të aplikojnë me projekte në lëmin e kulturës dhe sportit në kuadër të ditëve të Diasporës, duke përfshirë organizimin e festivalit “Mërgata Fest and Sports 2024”

Objektivat e thirrjes:

- Promovimi i kulturës,
- Nxitja e identitetit kulturor lokal (tradita e organizimit të festivalit „ Mërgata Fest and Sports 2024”
- Promovimi i turizmit kulturor,
- Promovimi i sportit (Sportet e veqanta),
- Zhvillimi i aftësive sportive,
- Ndergjegjësimi në gara sportive dhe Fair – Play
- Nxitja e bashkëpunimit në ekipe
- Zgjerimi i aktiviteteve të të rinjve
- Aktivitete të qendrueshme,
- Nxitja e kreativitetit dhe inovacionit

Vërejtje: Aktivitetet e “Mërgata Fest and Sports 2024 ” do të organizohen në sheshin “Adem Jashari” në Lipjan mes datave 26 korrik dhe 3 gusht 2024.

3. Përfituesi do të kujdeset për:

- Ofrimin e projektit me të cilin do të përmbushen objektivat e thirrjes publike dhe obligativisht netët festivetë janë të përfshira në projekt, ku minimalisht 3 emra të njohur të muzikës shqipe duhet të jenë pjesë e projekt propozimit, të cilët do të përformojnë në netët e caktuara sipas thirrjes, si dhe sigurimi i ambientit në të cilin do të zhvillohen sportet (detaje tjera do ti gjeni në udhëzuesin i cili do të publikohet në faqe së bashku me formularët për aplikim).

4. Organizatat jo-qeveritare mund të aplikojnë me një projekt që kontribuojnë në avancimin dhe fuqizimin e kulturës dhe sportit në Komunën e Lipjanit.

Numri i OJQ-ve që do të mbështeten nga kjo thirrje është një (1) OJQ.

Vlera totale e planifikuar sipas thirrjes është 35,000.00 € deri 50,000.00 € (tredhjetë e pesë mijë euro deri në pesëdhjetë mijë euro).

5. Afati i fundit për dorëzimin e propozimeve është 7 ditë pune dhe përfundon me datën 06.06.2024.

6. OJQ-të duhet të prezentoj në dokumente edhe dosjen për punët e ngjashme të kryera më herët, referencë për projektet e ngjashme nga financuesit.

Së paku një (1) Referencë nga personi përgjegjës dhe menaxheri i projektit për tri vitet e fundit (për punë, aktivitete të ngjashme).

OJQ –ja dhe Partneri i saj nuk duhet të kenë avance të pa mbyllura tek ofruesi i Thirrjes së paku 30 ditë para shpalljes së Thirrjes Publike.

Të drejtë aplikimi me projektet e tyre kanë OJQ-të që janë të regjistruara në regjistrin e organizatave jo-Qeveritare në Republikën e Kosovës që veprimtarinë e vet e zhvillojnë në Komunën e Lipjanit para datës së publikimit të thirrjes publike.

OJQ-të aplikuese duhet të dëshmojnë se programi i tyre i punës është i fokusuar në fushën e sportit dhe kulturës. OJQ duhet po ashtu të kenë kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit për OJQ-të në Republikën e Kosovës dhe në përputhje me rregullat e kontabilitetit si dhe të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj Drejtoratit të Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe të gjithë ofruesve tjerë të mbështetjes financiare publike.

Para nënshkrimit të kontratës, OJQ duhet të paraqesë prova se personi përgjegjës në OJQ dhe menaxheri i projektit nuk janë nën hetime për vepra penale, si dhe prova se OJQ ka zgjidhur çdo çështje të hapur rreth pagesës së kontributeve dhe tatimeve të papaguara, nëse është e aplikueshme.

7. Propozimet do të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë, të cilat së bashku me Udhëzimet për Aplikantët, janë në dispozicion në faqen e internetit të ofruesit të mbështetjes financiare (<http://kk.rks-gov.net/lipjan/>).

Dokumentet e kompletuara duhet të dorëzohen personalisht, në adresën e mëposhtme:

KOMUNA E LIPJANIT

Rruga „Shqipëria”

Zyra për shërbim të qytetarëve , nr 3,

Procesi i pranimi, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve, vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimi, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendarin tregues i zbatimit të thirrjes janë të detajuara në Udhëzimet për aplikuesit e thirrjes publike.

Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike, dhe të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara të thirrjes publike.

8. Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen vetëm në mënyrë elektronike, duke dërguar e-mail në adresën: anila.reqica.llugiqi@rks-gov.net

Drejtoreshë për Kulturë, Rinë dhe Sport

Anila Reqica Llugini

